



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 336/5 Prot

Tiranë, më 11.06.2021

V E N D I M

Nr. 72, datë 11.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e veprimit administrativ të DAP, për skualifikimin e konkurrentit *** , në fazën e verifikimit paraprak, gjatë procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve të shpalljeve me kod #3451, #3450, #3453, #3454.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një kërkesë të paraqitur prej aplikantit *****.

Vërej se:

Konkurenti ***** , nëpërmjet kërkesave protokolluar me nr. 336 prot., datë 22.02.2021 dhe 336/1 datë 09.03.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera nga ana e Departamentit të Administratës Publike, në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve të shpalljeve me kod # 3451, #3450, #3453, #3454.

Objekti i këtij procesi administrativ është vlerësimi i ligjshmërisë së veprimit administrativ të Departamentit të Administratës Publike, për skualifikimin e tij në fazën e

verifikimit paraprak, gjatë procedurës së pranimit në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve të shpalljeve me kod # 3451, # 3450, #3453, # 3454, me arsyetimin: - *“Nga librezat juaj e punës rezulton se jeni emëruar nëpunës civil në periudhë prove, pranë Bashkisë Tiranë. Në procedurat e pranimit në shërbimin civil, mund të aplikojnë vetëm kandidatët nga jashtë shërbimit civil”*.

Për këtë arsye, konkurenti kërkon ndërhyrjen e Komisionerit, pasi sipas kërkesë/ankesës paraqitur prej tij, pretendohet se trajtimi sa më sipër, është veprim i paligjshëm, diskriminues, pasi i mohohet padrejtësisht e drejta për punësim, sepse në legjislacionin e shërbimit civil nuk parashikohet asnjë kusht që mohon konkurimin e nëpunësit civil në periudhë prove. Ankuesi pretendon se *nëpunësi civil në periudhë prove nuk duhet të konsiderohet pjesë e shërbimit civil*.

Njëkohësisht ankuesi i është drejtuar edhe Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ky i fundit me shkresën nr. K/3/A15-5 datë 29.04.2021, i është drejtuar Komisionerit, në cilësinë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, për t’u informuar në lidhje me qëndrimin që do të mbahet në këtë rast.

Pas marrjes së informacionit të mësipërm ka nisur verifikimi paraprak i këtij rasti nga Komisioneri, duke kërkuar sqarime dhe dokumentacionin e nevojshëm nga Departamenti i Administratës Publike, i cili u përgjigj në lidhje me pretendimet e ankuesit, nëpërmjet shkresës nr. 1330/2, datë 15.04.2021, *“Kthim përgjigje”*, nga përmbajtja e të cilit rezultoi si më poshtë:

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, rezultoi se DAP, në zbatim të neneve 22, 23, 24, 25, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 243 datë 18.03.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar me VKM nr. 746 dt. 19.12.2018, ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv për grupin e pozicioneve të shpalljeve me kod #3451, #3450, #3453, #3454.

Rezulton që edhe nëpunësi në periudhë prove ***** , ka aplikuar për të gjitha pozicionet sa më sipër, por Departamenti i Administratës Publike, në fazën e verifikimit paraprak, e ka skualifikuar atë me arsyetimin se: *“Nga librezat juaj e punës rezulton se jeni emëruar nëpunës civil në periudhë prove, pranë Bashkisë Tiranë. Në procedurat e pranimit në shërbimin civil, mund të aplikojnë vetëm kandidatët nga jashtë shërbimit civil”* (e-maillet e skualifikimit paraqitur në ankesën e tij dhe dokumentacioni përfshirë edhe dosjen personale ardhur nga DAP në përgjigjen e tij).

Nga dokumentacioni që ka ngarkuar në dosjen elektronike, dorëzuar për aplikim rezulton e vërtetuar, se me aktin nr. 20653 prot., datën 24.06.2020, lënda *“Emërim”*, shtetasi

*****, është emëruar “nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit, në Drejtorinë Juridike”, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, pranë Bashkisë Tiranë.

Njësia përgjegjëse në shkresën e saj, sqaron se në procedurat e pranimit në shërbimin civil mund të konkurrojnë vetëm kandidatët nga jashtë shërbimit civil, pra individët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të vecanta të cilat bëhen të njohura në shpalljet për publikim.

Duke vazhduar me analizën e bazës ligjore që rregullon këtë institut të ligjit, rezulton se në përmbajtjen e pikës 1, të nenit 22, të ligjit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është e përcaktuar se: “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur”.

Më tej, në pikën 3/1 të po këtij neni ndër të tjera theksohet se: “...Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza: a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit; b) ... etj.”;

Për sa i përket procedurës së konkurimit për pranimin në nivelin ekzekutiv të shërbimit civil, në pikën 10, të Kreut II “Pranimi në Shërbimin Civil në Kategorinë Ekzekutive”, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, “Për Pranimin, Lëvizjen Paralele, Periudhën e Provës dhe Emërimin në Kategorinë Ekzekutive” (i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018), thuhet se: “Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët nga jashtë shërbimit civil”.

Pra, aplikantët që duhet të aplikojnë për procedurat e mësipërme duhet të jenë kandidatë nga jashtë sistemit të shërbimit civil, të pa emëruar në ndonjë pozicion tjetër pjesë të shërbimit civil.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara, në shpalljen për konkurrim të publikuar nga DAP, për grupin e pozicioneve me kod # 3451, # 3450, #3453, # 3454 (të verifikuara në faqen e internetit të DAP), rezultoi e shënuar në mënyrë të shprehur që:

“Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.....”.

Në rastin konkret ankuesi ***** ka rezultuar fitues në një procedurë të mëparshme konkurrimi të organizuar nga Bashkia Tiranë dhe në datën 24.06.2020, është emëruar nga njësia përgjegjëse e institucionit, nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist

në Sektorin e Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit, në Drejtorinë Juridike”, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, në këtë bashki

Në këto kushte njësia përgjegjëse (DAP) me të drejtë e ka skualifikuar konkurrentin ******, pasi ai nuk mund të konkurojë për procedurat e pranimit nga jashtë shërbimit civil, sepse aktualisht është pjesë e shërbimit civil.

Në lidhje me pretendimin se arsyet e skualifikimit janë veprim diskriminues, pasi sipas tij, i mohohet padrejtësisht e drejta për punësim, pa shkak të ligjshëm, sepse nëpunësi civil në periudhë prove nuk duhet të konsiderohet pjesë e shërbimit civil, sqarojmë se në rastin konkret ky pretendim nuk qëndron.

Referuar nenit 24, të ligjit të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar *“Nëpunësi, që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove, që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit”*, kështu që ankuesi ******, është pjesë e shërbimit civil dhe po i nënshtrohet periudhës së provës, që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

Duke qenë se nëpunësi civil në periudhë prove, i emëruar më parë në një pozicion pune sipas parashikimeve të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, është *de jure* pjesë e shërbimit civil, ai ka disa detyrime specifike të cilat janë në funksion të konfirmimit të tij si nëpunës civil. Presumohet që nëpunësi civil në periudhë prove duhet të jetë i përqëndruar në procesin e punës për të cilin është marrë në provë dhe nuk është normale që gjatë kësaj periudhe ai të bëjë përpjekje për të kaluar sa në një pozicion të nivelit ekzekutiv në një tjetër. Ky është shkaku që ligjvënësi ka vendosur kufizimin që nëpunësi civil në periudhë prove, si pjesë e shërbimit civil nuk lejohet të konkurrojë në pozicione të tjera të nivelit ekzekutiv, si konkurrent nga jashtë shërbimit civil.

Në këtë kuptim nëpunësi civil, qoftë në periudhë prove apo edhe i konfirmuar në një pozicion të shërbimit civil, nuk mund të aplikojë për procedurat e pranimit në pozicione të kategorisë ekzekutive, të cilat janë të dedikuara për kandidatët nga jashtë shërbimit civil (*të njejtin qëndrim ka mbajtur edhe DAP në përgjigjen e tij, drejtuar aplikantit, Komisionerit dhe Avokatit të Popullit, me shkresën me nr.1671/1 datë 26.03.2021*).

Përfundimisht, nisur nga gjithë sa u tha më sipër, konkludohet se në rastin konkret nuk ka vend për vazhdimin e mëtejshëm të hetimit administrativ dhe se çështja duhet të arkivohet, pasi vlerësohet se procedura e ndjekur dhe veprimet e kryera nga Departamenti i Administratës Publike, janë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e veprimit administrativ të DAP, për skualifikimin e konkurrentit ***** , në fazën e verifikimit paraprak, gjatë procedurës së pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve të shpalljeve me kod **#3451, #3450, #3453, #3454** dhe meqënëse veprimet e kryera gjenden në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislativonin e shërbimit civil, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Avokati i Popullit dhe aplikanti *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha